



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1760/prot.  
4

Elbasan, më 01.09.2025

VENDIM

Nr. 60 datë 01.09.2025

PËR

**MIRATIMIN E PLANEVE MËSIMORE TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT,  
BACHELOR, MASTER PROFESIONAL DHE MASTER I SHKENCAVE NË  
FAKULTETIN E BIZNESIT DHE TË DREJTËSISË PER VITIN AKADEMIK 2025-2026**

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 2, gërma "b", neni 25 pika 1, neni 35 pika 9, neni 38, Statutin e Universitetit "Aleksandër Xhuvani", të ndryshuar, neni 8 dhe 9, Rregulloren e UE-së, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 01. 09.2025,

V E N D O S I

- 1- Të miratojë planet mësimorë të programeve të studimit Bachelor, Master profesional, Master i shkencave, me kohë të plotë, për vitin akademik 2025-2026 të Fakultetit të Biznesit dhe Drejtësisë, si më poshtë:
1. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Financë-Kontabilitet".
  2. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Informatikë ekonomike".
  3. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Ekonomia dhe e drejta".
  4. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Ekonomi turizmi".
  5. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Administrim-Biznes".
  6. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në "Administrim-Biznesi dhe inxhinieri".
  7. Plani mësimor i programit të studimit të integruar të ciklit të dytë në "Drejtësi".
  8. Plani mësimor i programit të studimit Master profesional në "Informatikë Ekonomike".
  9. Plani mësimor i programit të studimit "Master profesional në "Ekonomia dhe e drejta në sektorin publik".
  10. Plani mësimor i programit të studimit Master profesional në "Marketing".

11. Plani mësimor i programit të studimit Master profesional në “Kontabilitet”.
12. Plani mësimor i programit të studimit Master profesional në “Administrim biznes”.
13. Plani mësimor i programit të studimit Master profesional në “Financë”.
14. Plani mësimor i programit të studimit Master i shkencave në “Drejtimit bankar”.
15. Plani mësimor i programit të studimit Master i shkencave në “Menaxhim”.
16. Plani mësimor i programit të studimit Master i shkencave në “Marketing”.
17. Plani mësimor i programit të studimit Master i shkencave në “Kontabilitet dhe auditim”.
18. Plani mësimor i programit të studimit Master i shkencave në “Ekonomia dhe e drejta në tregjet ndërkombëtare”.
19. Plani mësimor i programit të studimit Master i shkencave në “Informatikë ekonomike”.

2- Këto plane do të aplikohen për studentët që fillojnë studimet në vitin akademik 2025-2026.

3- Ngarkohet Dekani i Fakultetit i Biznesit dhe i Drejtësisë, Drejtorja e Kurrikulave dhe e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**Prof. Dr. Elvira FETAH**

